

342.721 (497.001):341.9

Mentor Sylmetaj<sup>1</sup>

**QËNDRIMI I LEGJISLACIONIT VENDOR DHE  
NDËRKOMBËTAR NDAJ MBROJTJES SË TË DHËNAVE  
PERSONALE DHE MBROJTJES NGA SHKELJA E PRIVATËSISË**

**СТАВОТ НА ДОМАШНАТА И МЕЃУНАРОДНАТА  
ЛЕГИСЛАТИВА ЗА ЗАШТИТА НА ЛИЧНИТЕ ПОДАТОЦИ И  
ЗАШТИТА НА ПРАВОТО НА ПРИВАТНОСТА**

**ACCES OF STAY OF LEGISLATION ON DOMESTIC AND  
INTERNATIONAL PROTECTION OF PERSONAL DATA AND  
PROTECTION OF PRIVACY VIOLATION**

**Abstract**

This paper presents a short brief introduction about the notion of protection of personal data and privacy violation. It addressed the protection of personal data in the Republic of Kosovo and violation of the privacy, with particular emphasis on the specification of legislation, which has to do with this area of law. Particularly it reflected the activity of the State Agency for Protection of Personal Data of the Republic of Kosovo, as well as reflections of this activity in the protection of privacy and personal data.

Also, there have been a legal provision in national domestic and international level, with emphasize of some actions of judicial and administrative bodies in their work which appear as an intrusion on privacy and personal data of individuals. Were highlighted, the possibilities of overcoming the legal authority, i.e. actions which are not in accordance with law, the justice system and the spirit of the law. The conclusions and recommendations are made available to co-ordinate, for the protection of privacy and personal data of individuals so that even if the interventions foreseen by the law, this intervention be limited to situations and criteria prescribed by law.

**Key words:** personal data, protection, violence, law for protection of the personal data, privacy, etc.

---

<sup>1</sup> Mentor Sylmetaj, magjistrant në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

### **Abstrakt**

Në punim është bërë një hyrje e shkurtër lidhur me nocionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shkëljes së privatësisë. Është trajtuar mbrojtja e të dhënave personale në Republikën e Kosovës dhe shkëlja e privatësisë, me theks të veçantë në specifikimin e rregullativës ligjore, e cila ka të bëjë me këtë fushë të së drejtës. Posaçërisht është pasqyruar veprimtaria e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës, si dhe reflektimet e kësaj veprimtarie në mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale. Gjithashtu, është bërë një vështrim i dispozitave ligjore në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtarë, dhe disa veprime të organeve gjyqësore dhe administrative gjatë punës së tyre të cilat paraqiten si ndërhyrje në privatësinë dhe të dhënat personale të individit. Janë vënë në pah, mundësitë e tejkalimit të autorizimeve ligjore, gjegjësisht veprimet të cilat nuk janë në harmoni me ligjin, të drejtën dhe me frymën e ligjit. Janë nxjerrë përfundimet dhe janë bërë rekomandimet e mundshme për koordinimin e veprimeve, me qëllim të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale të individit me qëllim që edhe në rast ndërhyrjeve të paraparë me ligj, kjo ndërhyrje të jetë e kufizuar vetëm në situatat dhe sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

### **1. Kuptimi dhe mbrojtja e të dhënave personale**

Objekti i këtij studimi është mbrojtja e të dhënave personale, rreziku i shkëljes së kësaj të drejte e cila është e garantuar edhe me aktet juridike më të larta të Shtetit dhe ato ndërkombëtare të trajtuara në thelb si liri fundamentale të njeriut. Pra objekti kryesor i trajtimit të kësaj teme e cila e trajton një nga të drejtat të cilësuar si më thelbësore të njeriut, siç është mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë, e cila paraqitet si fushë teorike dhe praktike e interesimit të juristëve dhe specialistë të tjerë që merren me teorinë e të drejtave të njeriut në lëminë e ligjëvënies, administratës dhe gjyqësisë. Me ritmin e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, bëhet e domosdoshme nevoja që të dhënat personale dhe privatësia e njeriut, të merren nën mbrojtje institucionale me një kuadër ligjor të veçantë dhe të punohet në sensibilizimin nga shumë institucione dhe organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, që në fokus të punës së tyre e kanë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Ruajta e dinjitetit të njeriut ka qenë dhe mbetet të jetë çështja kryesore e individit, shtetit dhe shoqërisë në përgjithësi. Në ndërtimin e këtij dinjiteti padyshim se rol të rëndësishëm ka dhe privatësia e individit. Mirëpo, me zhvillimin teknologjik në fushën e komunikimit ndërmjet njerëzve (themelimin e rrjeteve sociale si Facebook, Twitter,

etj.), kanë filluar të ndryshojnë edhe shumë koncepte shoqërore të cilat nuk kanë mbetur më në normimin klasik të tyre dhe na imponojnë edhe qasjen e Institucioneve relevante ndaj këtij “rreziku” i cili në mënyrën më të egër po na shfaqet çdo ditë e më shumë. Qytetari i sotëm i beson sistemeve të sigurisë së informacionit, që ka të bëjë me të dhënat e tij personale financiare në banka të ndryshme, depozita dhe transaksione të ndryshme financiare, të dhënat personale për pasaportën dhe kartën e identitetit, për votën, në shërbimet shëndetësore, etj. Kjo teknologji komunikimi dhe informacioni, sa vjen dhe zhvillohet drejt programeve dhe strategjive të reja. Siguria e këtyre të dhënave çdo ditë e më shumë po bëhet edhe më e kërcënueshme, për shkak të globalizimit të komunikimit dhe transferimit të të dhënave personale nga një vend në vendin tjetër.

## **2. E drejta për një jetë private, si një e drejtë themelore**

E drejta për një jetë private, si një e drejtë themelore e të drejtave të njeriut, përbën bazën e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes. Respektimi i tyre e bën të mundur progresin e plotë të individit dhe të shoqërisë. Zhvillimi i të drejtave të njeriut i ka rrënjët e veta në luftën për liri dhe barazi kudo në botë. Bazën e të drejtave të njeriut siç është respekti për jetën e njeriut dhe dinjitetin njerëzor e hasim në pjesën më të madhe të feve dhe të filozofive. Ato gjithashtu janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Dokumente si “Marrëveshja ndërkom-bëtare për të drejtat e njeriut”. Mbrojtja e të drejtave të individit në lirinë e shprehjes dhe sigurisë përbënë aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor të të gjitha qenieve njerëzore, këto të drejta themelore paraqesin thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut në të gjitha shtetet demokratike.<sup>2</sup> Duke qenë se mbrojtja e jetës private është shumë e rëndësishëm dhe rreziku për të ndërhyrë në të është i madh, neni 12 i DUDNJ mbron aspekte të veçanta të jetës private. Ky nen i kësaj deklarate që garanton mos cenimin e lirisë dhe garantimin e të drejtave të një personi që akuzohet për një vepër penale dhe me nene të tjera të konventës të cilat do të trajtohen në vijim, kontribuojnë në ruajtjen e jetës individuale të personit nga ndërhyrjet e paligjshme ose tejkalimi i të drejtave që ligji iu ka dhënë autoriteteve shtetërore. Elemente të nenit 12 para së

---

<sup>2</sup> Prof. Dr. Bashkim SELMANI, Roli i të drejtave të njeriut dhe pozita e qytetarëve sa ata i ndjejnë dhe i gëzojnë këto të drejta që i garanton legjislacioni i Republikës së Maqedonisë

gjithash, nocioni “jetë private” nuk jepet në këtë nen të deklaratës, por nga leximi i kujdesshëm i saj kuptohet që në jetën private përfshihen shumë elemente ndër të cilët më të rëndësishmit janë: familja, banesa, korrespondenca, jeta intime, morali, nderi dhe reputacioni i personit.

### **3. Përmes mbrojtjes së privatësisë synohet të mbrohet dinjiteti njerëzor**

Përmes mbrojtjes së privatësisë synohet të mbrohet dinjiteti njerëzor, i cili paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. E drejta për jetë, liria nga tortura, liria nga skllavëria, e drejta për liri dhe siguri, e drejta e respektimit të jetës private familjare, liria e shprehjes, e tubimit paqësor, e drejta për martesë, e drejta për arsim, për zgjedhje të lira, paraburgim për borxhe, liria e lëvizjes dhe të tjera të drejta janë parakushti kryesor mbi të cilin ngrihen ato që quhen të drejta njeriut. Në shumicën e rasteve këto fusha të ndërthuren më njëra tjetrën. Për këtë arsye, ato janë përfshirë dhe trajtohen nga një nen i përbashkët i Deklaratës Universale për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.<sup>3</sup> Në kuadër të privatësisë padyshim që pjesën më të madhe të këtij nocioni e përbën respektimi i fshehtësisë së korrespondencës ku gjen shprehje e drejta e individit për jetë private pasi nëpërmjet mbrojtjes së fshehtësisë së korrespondencës mbrohet privatësia e subjekteve që komunikojnë midis tyre<sup>4</sup>.

### **4. Koncepti korrespondence përfshin në vetvete të gjitha format e komunikimeve**

Koncepti “korrespondence” përfshin në vetvete të gjitha format e komunikimeve, të cilat realizohen nëpërmjet letrave, bisedave telefonike, mesazheve teleks, telegrameve, transmetim të dhënash ose fakse, si dhe të gjitha formave bashkëkohore të transmetimit të mesazheve radio, etj. Rëndësia e mbrojtjes së të dhënave dhe në kuadër të saj edhe të privatësisë merr një kuptim akoma më domethënës në realitetin e sotëm, ku njerëzit për arsye të angazhimeve të shumta, janë orientuar drejt komunikimeve elektronike të cilat nuk kërkojnë prezencën në një vend të caktuar, një moment të caktuar dhe mundësia për tu pajisur me një pajisje për të komunikuar me botën është më e lehtë se kurrë. Duke

<sup>3</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Neni 12), dhjetor të vitit 1948.

<sup>4</sup> Ronco, M.& Ardizzione, S.(2007). Codice Penale Ipertestuale: Commentario con banca dati di giurisprudenza e legislazione. Utet Giuridica, f. 2664.

pasur parasysh rëndësinë që ka kjo e drejtë, hartuesit e akteve kryesore në fushën e të drejtave të njeriut e kanë renditur të drejtën e respektimit të korrespondencës në radhën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Sipas filozofit të njohur John Stuart Mill, privatësia ndikon në mënyrë thelbësore në autonominë e sjelljes së individit. Çdo person për të qenë autonom, ka nevojë për një sferë private e cila lehtëson zhvillimin e tij personal, aftësinë për t'u përfshirë në marrëdhënie intime dhe për t'u shprehur lirisht. Nga këndvështrimi sociologjik, privatësia konsiderohet se ka një vlerë shumë të veçantë pasi rregullon marrëdhëniet e individit me shoqërinë përreth. Sipas kësaj pikëpamjeje, nevoja për të pasur të drejtën për jetë private krijohet në shoqëri. Pa ekzistencën e shoqërisë në tërësi, nuk do të ekzistonte nevoja për njohjen e kësaj të drejte. Qeniet njerëzore mbështeten mbi raporte që përcjellin dashuri dhe vetëvlerësim, të cilat janë thelbësore për zhvillimin personal. Kjo për arsye se pikërisht në të tilla raporte, mund të fitohet vetëbesimi i nevojshëm për shpalljen e identitetit personal.

### **5. E drejta e respektimit të jetës private, dhe familjare**

E drejta e respektimit të jetës private, dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera, garantohet edhe me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>5</sup>, por në lidhje me normimin e kësaj të drejte nga akti më i lartë juridik i shtetit do të flasim në kapitujt në vijim. Gjithashtu sjelljet e njerëzve rregullohet me lloje të ndryshme normash: morale, religjioze, juridike dhe bashkësia shoqërore është e pa mundur të ekzistojë pa ekzistimin e rregullave të cilat e rregullojnë jetën në të. Nga të gjitha rregullat që rregullojnë sjelljen e njeriut, normat juridike janë më të rëndësishmet. Norma juridike është rregull shoqërore e detyrueshme për sjelljen e njerëzve e sjellë (ose) e sanksionuar nga shteti, gjegjësisht e mbrojtur nga aparati shtetëror. Ajo do të thotë se rregulli shoqëror për sjelljen e njerëzve mund të krijohet edhe nga ana e shtetit, kur ajo është e sjellë nga ana e organit kompetent shtetëror, ose shteti të sanksionojë normë të caktuar shoqërore. Fuqia dhe rëndësia e normës juridike rrjedh nga fakti se ajo është e mbrojtur nga aparati shtetëror. Ai fakt edhe e dallon nga normat e tjera shoqërore.

Nisur nga kjo, me këtë “vetpajtim“ që ta shkelim këtë të drejtë, po arrijmë te ajo që e drejta e privatësisë nuk ka nevojë më të mbetet e

<sup>5</sup> Neni 36, Kushtetua e Republikës së Kosovës.

drejtë e garantuar me këto instrumente. Kjo sepse njëra ndër mënyrat e pushimit të vlefshmërisë të një norme juridike është edhe ajo kur norma juridike mbetet pa objekt rregullimi. Kështu, e drejta e privatësisë, duke u cenuar nga vet shoqëria, nëpërmes rrjeteve sociale, po mbetet pa objektin e saj që është privatësia. Andaj, si e tillë, duke u shkelur nga vet shoqëria, e drejta e privatësisë është duke shkuar në drejtimin i cili po e dërgon në humbje të efektit të vet si një e drejtë themelore e individit.<sup>6</sup>

I vetmi këndvështrim që kjo e drejtë të jetë e drejtë e garantuar është ai i shtetit përballë individit, pra ajo se shteti me organet e tij nuk guxon ta shkel këtë të drejtë. Sot, jurisprudenca e vetë Gjykatës së Strasburgut i ka parë shkeljet e të drejtave të njeriut jo vetëm në linjë vertikale (shtet-individ) por edhe horizontale (individ-individ), duke vendosur mbi shtetet detyrime pozitive.

## **6. Zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit pasojat dhe sfidat**

Synimi në radhë të parë është të paraqesë ndikimin që kanë pasur në zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shfaqjen e formave të reja që kriminale që drejtohen kundër të dhënave personale dhe shkeljes së privatësisë në shoqërinë e sotme bashkëkohore dhe në veçanti në Republikën e Kosovës. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt elementet e reagimit ligjor ndaj kërcënimeve që vijnë nga hapësira teknologjike, lind në mënyrë të pashmangshme domosdoshmëria e studimit të natyrës dhe veçorive specifike që paraqet ky drejtim i ri i veprimtarisë antiligjore. Trajtimi i rrethanave të zbatimit të përgjegjësisë për këto veprime të paligjshme, merr parasysh në mënyrë të veçantë kompleksitetin e mjedisit virtual në të cilin ato zhvillohen.<sup>7</sup>

Me interes të veçantë është trajtuar roli kyç i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në luftën kundër veprimeve antiligjore që kryhen nëpërmjet ose kundër sistemeve kompjuterike, si dhe personat përgjegjës të cilët janë të autorizuar të ruajnë të drejtat e njeriut në këtë

<sup>6</sup> Zahir Çerkini, "Telegrafi".

<sup>7</sup> Ky punim vendos theksin në faktin se krahas vëmendjes për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, gjithashtu i kushtohet rëndësi hartimit të strategjive gjithëpërfshirëse në luftën kundër kësaj dukurie negative, e që është shqetësuese për shoqërinë, të cilat ndajnë qartë rolet, përgjegjësitë si dhe modelet e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm publik dhe privat, dhe që parashikojnë masa konkrete për promovimin e një kulture të mirëfilltë, në radhët e shoqërisë.

drejtim, duke qenë se realizimi me përgjegjësi i detyrave të tyre për mbrojtjen e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike ndikon ndjeshëm në kontrollin e rrezeve të sulmeve të paligjshme. Në këtë perspektivë, analizohen edhe detyrimet e posaçme ligjore për mbrojtjen e privatësisë në lidhje me të dhënat me natyrë personale që përpunohen për qëllime të ofrimit të shërbimeve të informacionit. Një pjesë të rëndësishme në këtë punim, zë edhe studimi i kushteve, në të cilat, subjektet e përcaktuara nga ligji mund të ndërhyjnë në të dhënat personale dhe në ruajtjen e privatësisë, si e drejtë që e parashih kushtetuta në rend të parë, si dhe ligjet tjera që mbrojnë këto të drejta themelore, bazuar në premisën që kjo e drejtë nuk është absolute dhe në rrethana të caktuara të ligjshme mund të kufizohet.

### **7. Rrethanat praktike në të cilat autorizohet ndërhyrja apo kufizimi**

Qëllimi është që të kuptohen drejtë rrethanat praktike në të cilat autorizohet ndërhyrja apo kufizimi si dhe të diskutohet mbi proporcionalitetin e mundshëm të interesave publik dhe privat që përplasen në këto situata. Ky punim ka për qëllim që të demonstroj nevojën e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës.

Rëndësia e implementimit të këtij ligjit qëndron në faktin se ky ligj është i ndërlidhur drejtpërsëdrejti me fusha tjera tejet të rëndësishme si: mbrojtja e të drejtave të njeriut, e drejta penale dhe ajo e procedurës penale, antikorrupsioni, telekomunikacioni, regjistrimi civil, sektori privat si dhe me fusha tjera të rëndësishme të ndërlidhura me mbrojtjen e të dhënave personale.

### **Conclusion**

In this scientific work significant concerns have been raised regarding the implementation of legislation in the area of protecting personal data. Also, during this research they are found to be miss harmonization of legislation that does regulate with other legislation courier. That's because the part of accompanying legislation has been promulgated before the adoption of this law, which leaves room for controversy as regards alignment with the protection of personal data.

The paper also highlights that some very important processes of collecting personal data have been taken last year without taking into considerate the Law on Protection of Personal Data, even though this

law was in force. Therefore, the main purpose of this research is to encourage key stakeholders and the public to take the necessary prevention and awareness as fast storing personal data and privacy, how should act when these rights have been violated. That finds further push given especially when well-known fact that only a small number of people have information about the existence of this law.<sup>8</sup>

### **Bibliografia**

1. *Bashkim Dr. Selmani "Roli i të drejtave të njeriut dhe pozita e qytetarëve sa ata i ndjejnë dhe i gëzojnë këto të drejta që i garanton legjislacioni i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2014*

2. E Drejta Romake, ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore, Prof. Dr. Bashkim Selmani, Mr. Asc. Bekim Rexhepi, Instituti Ndërkombëtar për Hulumtime Shkencore.

3. E Drejta Familjare dhe Trashëgimore (Romake), ndikimi i saj në shoqërinë bashkëkohore Shqiptare, Prof. Dr. Bashkim Selmani, Mr. Asc. Bekim Rexhepi.

4. Njeriu si qenie njerëzore i cili drejton dhunën kundër vetes apo të tjerëve – pasojat e kohës apo kohëzgjatje e tranzicionit në Republikën e Maqedonisë

5. E drejta procedural administrative /Agur Sokoli-Prishtinë: Universiteti i Prishtinës: Fakulteti Juridik, 2005 (shtëpia botuese: "Dino Graf" Ferizaj),

6. E drejta Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Tekst dhe material; Mark W. Janis, Richard S. Kay & Anthony W. Bradley, Shtëpia botuese: "Libri Shkollor", Prishtinë, 2002,

7. Marko Bello, E drejta institucionale komunitare evropiane, Tiranë, ribotim, 2008.

8. E drejta e procedurës penale, Dr.sc. Ejup Sahiti, Universiteti i Prishtinës në Prishtinë-Fakulteti Juridik, Prishtinë 2005,

9. DZLP, KOMENTAR Na zakonot za Zaštita na ličnite podatoci, Skopje, 2010,

---

<sup>8</sup> Ky punim ka për qëllim që të shërbejë si identifikues i problemeve në fushën e të dhënave personale, me anë të të cilit shoqëria do të ketë më shumë njohuri rreth kësaj fushe.



10. Procedura penale (Komentar); Dr. Azem Hajdari, Universiteti Fama-Fakulteti Juridik, Prishtinë 2010.
11. Abdullah Aliu, *E drejta Civile*, Prishtinë 2013;
12. Agur Sokoli, *E drejta e Procedurës Administrative*, Prishtinë 2005;
13. Arben Puto, *E Drejta ndërkombëtare publike II*, 1995;
14. Asllan Bilalli dhe Dr. Hajredin Kuçi, *E Drejta Ndërkombëtare Private* Prishtinë 2009;
15. Ermir Dobjani, *E drejta Administrative I*, Tiranë, 2003;
16. *Të drejtat e njeriut* përmbledhje e instrumentesh ndërkombëtare, publikim i OHCHR, 2004;
17. Hajdari, A. *Kriminaliteti i organizuar*, Prishtinë 2006;
18. Poda, Z. *Krimi i organizuar*, Tiranë 1998;
19. Ismet Salihu, *E drejta penale*, pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012;
20. Ismet Salihu, *E drejta penale*, pjesa e posaçme, Prishtinë 2006;
21. Sahiti, E. *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë 2005; Mark W. Janis, Richard S. Kay & Anthony W. Bradley, *E drejta Evropiane e të Drejtave të Njeriut*, Prishtinë, 2002
22. Zejnulah Gruda *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut libri I dhe II*, 2007;
23. *Principles of Information Security*, Michael E Whitman, Herbert J. Mattord
24. *European Data Protection: In god Health*, Serge Gutwirth, Ronald Leenes, Paul De Hert, Yves Poullet
25. Ronco, M. dhe Ardizzone, S. (2007). *Codice Penale Ipertesuale: Commentario con banca dati di giurisprudenza e legislazione*. Utet Giuridica, f. 2664
26. *Data Protection, for voluntary organisations*, Paul Ticher
27. Dr. Sc. Veton G. Vula, *Kriminaliteti Kompjuterik*, Prishtinë 2010
28. *Gjykata Evropiane dhe e Drejta për Jetë Private*